

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**, gjyqtari **Betim Behluli**, me bashkëpunëtorin profesional **Armond Qmega**, në çështjen juridike të paditësit A. M. D. nga Rahoveci, të cilin e përfaqëson përfaqësuesi i tij i autorizuar Q. Q. Avokat nga Rahoveci, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, kundër të paditurit D. G. S. nga Rahoveci, të cilët e përfaqëson i autorizuari i tij A. D. nga Rahoveci, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, për shkak të vërtetimit të pronësisë në bazë të parashkrimit fitues, vlera e kontestit 950,00 Euro, pas mbajtjes dhe përfundimit të shqyrtimit kryesor dhe zbatimit të provave, më **13.02.2019**, morri këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**APROVOHET** kërkesëpadia e paditësit **A. (M.) D., SI E BAZUAR.**

**VËRTETOHET SE** paditësi është pronar i paluajtshmërisë si parcelë kadastrale nr. 4897-32, në sipërfaqe prej 300 m<sup>2</sup>, ZK Rahovec, në bazë të parashkrimit fitues, çka **i padituri** është **obliguar** që të pranojë këtë të drejtë dhe të lejojë që paditësi të regjistrohet si pronar në regjistrin Kadastral të Pronave pranë Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë në Rahovec, ku si bazë juridike do të shërbejë ky aktgjykim dhe në afat prej 15 ditë nga dita e pranimit të aktgjykimit, nën kërcënimin të përmbarimit të detyrueshëm.

**Shpenzimet procedurale sipas marrëveshjes i bartë paditësi.**

### **A r s y e t i m**

Paditësi A. M. D., nëpërmjet përfaqësuesit të tij të autorizuar kanë ushtruar padi kundër të paditurit D. G. S., për shkak të vërtetimit të pronësisë në bazë të parashkrimit fitues.

Sipas kësaj çështje juridike gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor me datën 13.02.2019, në të cilët janë paraqitur përfaqësuesi i autorizuar i paditësit Avokati Q. Q., si dhe i autorizuari i të paditurit A. D..

Përfaqësuesi i autorizuar i paditësit Avokat Q. Q., deklaroi se ngel në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, të thënave të cekura në padi, marrë parasysh faktin se pala e paditur, përmes përgjigjes në padi nuk e ka kontestuar kërkesëpadinë por e ka pohuar faktin vendimtar se paditësi A. në vitin 1999, e ka pas blerë paluajtshmërinë që është objekt i padisë dhe se prestacionet nga kjo padi janë realizuar në mënyrë të dy anshme në atë mënyrë që paditësi është vuar në posedim të paluajtshmërisë, në të cilën e ka ndërtuar objektin e banimit për nevojat e familjes, objekt ky i cili është nisur mbi themele nga pala e paditur, ndërsa i njëjti është paguar në tërësi me çmimin e tregut të vitit 1999, por bartja prej të paditurit si pronar formal në paditësin si blerës nuk ka mundur të bëhet për shkak të pengesave administrative. Për këtë arsye pa marrë parasysh se padia dhe përgjigje në padi, janë përafërsisht identike sa i

përket objektit të kontestit, i propozojmë gjykatës pas administrimit të provave kërkesëpadinë ta miratojë si me bazë, me qëllim të vërtetimit të pretendimeve në padi, që të bëhet identifikimi në terren i parcelës kontestuese. Ndërsa në fjalën përfundimtare i propozoj gjykatës që pas procedimit të provave kërkesëpadinë e paditësve ta miratojë si me bazë.

I autorizuari i të paditurit A. D., deklaroi se ngel në tërësi pranë përgjigjes në padi prej datës 08.01.2019, duke shtuar se pretendimet në padi janë plotësisht të sakta dhe se i padituri S. D., me vullnetin e tij e ka tjetërsuar paluajtshmërinë kontestuese dhe është paguar në tërësi me çmimin e shitblerjes së tregut ndërsa blerësin e ka vuar në posedim qysh në vitin 1999 pa asnjë vërejtje. Nuk e kundërshtoi që të bëhet identifikimi i parcelës në vendin e ngjarjes dhe në fund i propozoj gjykatës që të aprovojë në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar.

Për të vërtetuar faktet vendimtare, gjykata i ka zbatuar këto prova: ka bërë shikimin në certifikatën e pronësisë prej datës 31.10.2018, ka bërë shikimin në përgjigjen në padi prej datës 08.01.2019, ka bërë shikimin në ekspertizën e ekspertit gjeometër R. K. prej datës 13.02.2019, dhe ka bërë shikimin në skicën e terrenit prej datës 13.02.2019.

Pas analizimit dhe vlerësimit të secilës provë veç e veç, duke i vlerësuar në deklaratat e ndërgjyqësëve si dhe duke u mbështetur në dispozitën e nenit 7 dhe 8 të LPK-së, në bazë të të bindjes së vetë të lirë, është konstatuar se kërkesë padia e paditësve është **e bazuar dhe e njëjta është aprovuar.**

Nga provat të zbatuara është vërtetuar kjo gjendje faktike:

Me shikimin në certifikatën e pronësisë prej datës 31.10.2018, vërtetohet se parcela nr. 4897-32 evidentohet në emër të të paditurit D. G. S..

Me shikimin në shikimin parashtresën përgjigjen në padi prej datës 08.01.2019, nga e cila vërtetohet se i autorizuari i të paditurit e vërteton është kryer shitblerja dhe nuk e konteston që patundshmëria të bartet në emër të paditësit.

Me shikimin në ekspertizën e ekspertit gjeometër R. K. prej datës 13.02.2019, vërtetohet se parcela kadastrale nr. 4897-32 gjendet në veri-lindje të qytetit të Rahovecit me kulturë është Oborr (jo pjellore) është në ndërtim një shtëpi banimi P+1 e ndërtuar nga ana e paditësit A. M. D..

Si fakte relevantë në këtë çështje juridike, gjykata muarr për bazë se është argumentuar fakti se paditësi është në posedim të ligjshëm dhe mirëbesim dhe i padituri i ka pranuar të hollat.

Ligji për Pronësi dhe të Drejta tjera Sendore me dispozitën e nenit 40 al 1 parasheh se: ***Personi i cili me mirëbesim e ka njëzetë (20) vjet në posedim të pandërprerë një paluajtshme ose një pjesë të saj, e fiton pronësinë në të,*** sipas kësaj gjendje të vërtetuar gjykata vlerëson se paditësit në shfrytëzim të pronës kontestuese janë vendosur posedim të ligjshëm dhe mirëbesim rreth mbi 20 vite, i cili kusht është plotësuar edhe me LTHMPJ-së sipas dispozitës së nenit 28 al. 4.

Në bazë të gjendjes faktike të cekur më lartë e duke u mbështetur në dispozitën e nenit 28 al. 4 të LTHMPJ-së, dhe nenit 40 al. 1 të Ligjit për Pronësi dhe të Drejta tjera Sendore, si dhe neneve 143 dhe 254 dhe 319 të LPK-së ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

**Vendimi mbi shpenzimet procedurale është mbështetur në dispozitën e nenit 450 të LPK-së.**

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, datë 13.02.2019  
C.nr.426/2018.**

**B. Profesional  
Armond Qmega**

**Gjyqtari  
Betim Behluli**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimet të këtij aktgjykimi, ankesa paraqitet nëpërmjet të kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit, Divizioni Civil në Prishtinë.